

Njoftim për përqendrim me të cilin PRVA CAP d.o.o., Fond i Posaçëm i Investimit, k.d., Lubjanë, Republika e Sllovenisë, AORTA HOLDING, veprimtari investuese, d.o.o., Lubjanë, Republika e Sllovenisë dhe SMART DATA SECURITY ADRIATIC, veprimtari investuese, d.o.o., Lubjanë, Republika e Sllovenisë, do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi ASCALAB, zgjidhje dhe zhvillim informatik, d.o.o., Lubjanë, Republika e Sllovenisë (lënda nr. 08-131/2026)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 05.06.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin **PRVA CAP d.o.o., Fond i Posaçëm i Investimit, k.d. (PRVA CAP d.o.o., Specialni investicijski sklad, k.d.)**, me seli të regjistruar në rrugën Fajfarjeva nr. 33, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë, **AORTA HOLDING, veprimtari investuese, d.o.o. (Aorta Holding, naložbena dejavnost, d.o.o.)**, me seli të regjistruar në rrugën Jozheta Mirtiça nr. 9, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë dhe **SMART DATA SECURITY ADRIATIC, veprimtari investuese, d.o.o. (Smart Data Security Adriatic, naložbena dejavnost, d.o.o.)**, me seli të regjistruar në rrugën Legatova nr. 2B, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë, do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi **ASCALAB, zgjidhje dhe zhvillim informatik, d.o.o. (ASCALAB, informacijske rešitve in razvoj, d.o.o.)**, me seli të regjistruar në rrugën Legatova nr. 2B, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

PRVA CAP d.o.o., Fond i Posaçëm i Investimit, k.d. është i regjistruar në Regjistrin Tregtar të Sllovenisë për veprimtari të fondeve investuese në tregjet monetare dhe jo monetare. Fondi kryesisht investon në ndërmarrje të vogla dhe të mesme, ndërsa në vitin 2025 ka realizuar investim në shoqërinë sllovene KUKINOX d.o.o. (Cookinox d.o.o.), e cila është e përfshirë në prodhimin dhe shitjen e pajisjeve për katering.

PRVA CAP d.o.o., Fond i Posaçëm i Investimit, k.d. është pjesë e Grupit më të gjerë PRVA.

PRVA CAP menaxhohet nga PRVA CAP, menaxhim i investimeve, d.o.o. (PRVA CAP, upravljanje naložb, d.o.o.), me seli të regjistruar në rrugën Fajfarjeva nr. 33, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë, e cila ushtron veprimtari të menaxhimit të fondeve alternative të investimit në përputhje me Ligjin slloven për menaxhuesit e fondeve alternative të investimit.

PRVA CAP d.o.o. aktualisht menaxhon një fond alternativ investimi për kapital privat me emërtimin Fondi PRVA CAP (Sklad PRVA CAP), i cili është organizuar në formën e një shoqërie komandite të veçantë (sllov. komanditna družba – k.d.). PRVA CAP d.o.o. nuk ka investime të tjera dhe as shoqëri të varura. PRVA CAP d.o.o. është i regjistruar për ushtrimin e veprimtarive të tjera të shërbimeve financiare, përveç sigurimit dhe financimit pensional.

Grupi PRVA është i pranishëm dhe realizon të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes dy shoqërive të varura në vijim:

- **KB Prvo Penzisko Drushtvo AD Shkup**, me seli të regjistruar në rr. Mitropolit Teodosij Gologanov nr. 6, 1000 Shkup, i regjistruar me numër regjistrimi 5990815, me veprimtari prioritare të regjistruar: menaxhimi i fondeve të detyrueshme dhe vullnetare

të pensioneëve, duke përfshirë menaxhimin e mjeteve të fondeve, përfaqësimin para palëve të treta dhe veprimtari të tjera që lidhen me menaxhimin e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare të pensioneëve; dhe

- **Prva Život SHA Shkup**, me seli të regjistruar në rr. Mitropolit Teodosij Golomanov nr. 6/1-2, 1000 Shkup, i regjistruar me numër regjistrimi 7687826, me veprimtari prioritare të regjistruar: sigurimi i jetës. Prva Život është shoqëri për sigurimin e jetës, e cila ofron produkte për sigurim të jetës për rrezik dhe sigurim të jetës të lidhur me investime.

AORTA HOLDING, veprimtari investuese, d.o.o. është shoqëri holding e cila merret me zotërimin dhe menaxhimin e pjesëmarrjeve në dy shoqëritë në vijim:

- ASCALAB, zgjidhje dhe zhvillim informatik, d.o.o. (ASCALAB); dhe
- iTeamExtend, zgjidhje informatike, d.o.o. (iTeamExtend, informacijske rešitve, d.o.o.), me seli të regjistruar në rrugën Jozhe Mirtiça nr. 9, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë.

AORTA HOLDING, veprimtari investuese, d.o.o., duke përfshirë ASCALAB dhe iTeamExtend, nuk është e pranishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk ka realizuar asnjë të ardhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

SMART DATA SECURITY ADRIATIC, veprimtari investuese, d.o.o. ushtron veprimtari në fushën e sigurisë së informacionit dhe shërbimeve të tjera në fushën e teknologjisë së informacionit.

Smart Data Security Adriatic nuk është e pranishme dhe nuk realizon asnjë të ardhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

ASCALAB, zgjidhje dhe zhvillim informatik, d.o.o. është e përfshirë në ofrimin e shërbimeve të programimit kompjuterik, kryesisht në zhvillimin e softuerit me porosi B2B, zhvillimin e aplikacioneve mobile dhe shërbimet e integritetit të sistemeve në sektorë të ndryshëm, si dhe në shërbimet që lidhen me migrimin në cloud, DevOps dhe shërbimet UI/UX.

Në vitin 2025, ASCALAB, zgjidhje dhe zhvillim informatik, d.o.o. i ka ofruar shërbimet e saj klientëve në Slloveni, Mbretërinë e Bashkuar, Holandë dhe Gjermani.

ASCALAB, zgjidhje dhe zhvillim informatik, d.o.o. ka vetëm një degë, **Ascalab Ogranak Niš (Ascalab Ogranak Niš)**, me seli të regjistruar në rrugën Proletna nr. 6, Donja Vrežhina, Pantelej, Republika e Serbisë. Dega është tërësisht e varur nga ASCALAB, zgjidhje dhe zhvillim informatik, d.o.o. dhe nuk përbën person juridik të veçantë.

ASCALAB, zgjidhje dhe zhvillim informatik, d.o.o. nuk është e pranishme dhe nuk realizon asnjë të ardhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Sipas parashtruesve të njoftimit, tregu përkatës i mallrave, të cilit i referohet përqendrimi, duke marrë parasysh aktivitetet e ardhshme të Shoqërisë së Synuar në nivel botëror, mund të përkufizohet si tregu i programimit kompjuterik, ndërsa shtrirja gjeografike e tregut përkatës si kombëtare, përkatësisht territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.. Megjithatë, vendimi përfundimtar lidhur me këtë çështje është rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara që të paraqesin vërejtjet dhe mendimet e tyre lidhur me këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. „Shën Kirili dhe Metodi“ nr. 54, Shkup, ose në e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

21.09.2026

Shkup